



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 487 Prot.

Tiranë, më 05. 04. 2018

V E N D I M

Nr. 98, Datë 05. 04. 2018

Bazuar në informacionin e marrë nga Organizata “SFINKSI” e Minoritetit të Egjiptianëve të Shqipërisë për Zhvillim dhe Integrim, si dhe mbështetur në ligjin Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 32, pika 1/c, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me Urdhërin nr. 196, datë 29.12.2017, ka filluar procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes së rregjistrimit të studentëve të komunitetit Egjiptian, pranë Fakultetit të Shkencave Sociale Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Sipas informacionit të dhënë nga Shoqata “Sfinksi”, studentët e komunitetit Egjiptian, që ndjekin studimet pranë Fakultetit të Shkencave Sociale Tiranë, kanë ngritur shqetësimin kundrejtë zyrës së financës së këtij institucioni, pasi gjatë rregjistrimit në këtë fakultet, u kërkohen dokumenta si p.sh.: vetdeklarim pranë noterit për përkatësi në komunitetin egjiptian apo deklarata nga shoqata ku aderojnë. Fakti që studentët mund të vetdeklarohen përpara noterit si individ që i përkasin komunitetit egjiptian, mund të përbëjë shkak për abuzime, si dhe i ngarkohet një kosto financiare e tepruar. Në këto kushte dhe për shkak të masave shtërnguese të marra nga ana e Fakultetit të Shkencave Sociale Tiranë, 40 studentë të nivelit bachelor dhe 10 të nivelit master, rrezikojnë të braktisin studimet.

Diskriminimi për shkak të racës është një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/1, parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndërmori hapat proceduralë si më poshtë vijojnë :

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vijoi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me anë të shkresës nr. 142 prot., datë 24.01.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, iu drejtua Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Shkencave Sociale, në të cilën kërkoi informacion mbi pretendimet e organizatës “SFINKSI”.

- Me shkresën¹ nr. 98/1 prot., datë 02.02.2018, Fakulteti i Shkencave Sociale Tiranë, informoi Komisionerin lidhur me pretendimet e ngritura, ku ndër të tjera sqaroi se: *“...duam t’iu sigurojmë se FSHS ka pasur dhe ka gjithnjë prioritet, në politikën e pranimi të studentëve, rritjen e kuotave për të gjithë grupet në nevojë dhe më specifikisht për minoritetin Rom dhe Egjiptian. Si pasojë e kësaj politike FSHS është institucioni që ka sot numrin më të madh të studentëve Rom dhe Egjiptian që studiojnë në të dy nivelet e studimit. FSHS për aplikimin dhe rregjistrimin e kandidatëve nga minoriteti Rom dhe Egjiptian në programet Bachelor dhe Master, ka ndjekur Udhëzimin e MASR, Nr. 18, datë 16.08.2017. Ky udhëzim për programin Bachelor, Kreu VI/2 pika 8, gërma e (fq. 7 e Udhëzimit) dhe për programin Master, kreu VI/4 pika 11, gërma c (fq. 13 e Udhëzimit), kërkon që aplikantët fitues nga minoriteti Rom dhe Egjiptian, të dorëzojë gjatë fazës së rregjistrimit si dokumentacion shtesë dhe vet-deklarimin ose një dokument që vërteton se kandidati në fjalë është pjesë e komunitetit rom apo egjiptian. Kandidatët fitues janë rregjistruar sipas Udhëzimit 18 dhe nuk ka pasur asnjë ankesë në lidhje me rregjistrimin e studentëve fitues. Lidhur me pretendimet e organizatës “Sfinksi” mendojmë se janë të pavërteta, pasi studentët e minoritetit rom/egjiptian që studiojnë në programet Bachelor në FSHS janë përjashtuar nga tarifa e shkollimit. Ky përjashtim vjen nga zbatimi i vendimit të Këshillit të Ministrave. Kjo VKM nuk përjashton nga tarifa e studimit studentët e programeve Master. Në këto kushte këta studentë janë të detyruar të paguajnë tarifën e studimit. Megjithatë, FSHS, për ti ardhur në ndihmë kësaj kategorie studentësh në programet Master, ka vendosur një skemë pagese me këste për të lehtësuar detyrimin e menjëhershëm të tarifës së shkollimit”.*
- Me shkresën² nr. 395/3 prot., datë 02.02.2018, Universiteti i Tiranës, informoi Komisionerin lidhur me pretendimet e ngritura, ku ndër të tjera sqaroi se: *“...Mbështetur në Udhëzimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, citohet se dokumentacioni i cili duhet të dorëzohet nga studentët e kësaj kategorie, duhet të ishte një deklaratë e përkatësisë etnike pranë noterit, në të cilët studentët duhet të vetdeklarojnë etninë e tyre. Ky qëndrim i MSHMS, vjen me qëllimin për të shmangur abuzimet që kanë ndodhur ndër vite nga shoqata të ndryshme. Ndërsa, përsa i përket përjashtimit të kategorieve të studentëve që plotësojnë kriteret për pranim në ciklin e dytë të studimeve, ju informojmë se ligji për*

¹ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 142/1 prot., datë 05.02.2018

² Protokolluar pranë KMD-së me nr. 142/2 prot., datë 01.03.2018

arsimin e lartë nuk ka parashikuar se kategori të veçanta studentësh do të vazhdojnë të përfitojnë nga garancia për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për studimet në ciklet e dyta, pra në Master, duke i lënë detyrë të jenë vetë institucionet e arsimit të lartë, ato të cilët do të vlerësojnë dhe do të jenë kategoritë që do të përjashtohen nga tarifa e shkollimit. Për këtë arsye, bazuar në nenin 3 të ligjit nr. 80/2015, i cili parashikon se: “institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi”, senati Akademik i Universitetit të Tiranës me vendimin e tij nr. 06, datë 26.04.2017 “Për miratimin e disa rregullave lidhur me aplikimin e tarifave të shkollimit për programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, për vitin akademik 2016-2017” në pikën 6, ka vendosur se studentët e shkëlqyer sipas rregullores së Universitetit të Tiranës do të përfitojnë përjashtim nga tarifa studentore, duke mos përfshirë asnjë kategori tjetër studentësh.”

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

I. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

A. Lidhur me pretendimin e organizatës “Sfinksi” për trajtim të pabarabartë dhe të disfavorshëm nga Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Universiteti i Tiranës, për shkak të racës.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Së pari, nga këqyrja dhe verifikimi i informacioneve dhe dokumentacionit në dosje rezulton se:

- Referuar në shkresën me nr. 13/1 prot., datë 18.01.2018 dhe dhe nr. 13/3, datë 07.02.2018 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Sociale i ka komunikuar Universitetit të Tiranës, se në zbatim të VKM nr. 269, datë 29.03.2017 për “Përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, ka përcaktuar se dokumentacioni që duhet dorëzuar nga studentët e kategorisë rom/egjiptian, duhet të jetë një deklaratë e përkatësisë etnike pranë noterit, në të cilën studentët duhet të vetdeklarojnë etninë e tyre.

- Në zbatim të sa mësipër dhe për ti ardhur në ndihmë studentëve të komunitetit rom/egjiptian Fakulteti i Shkencave Sociale ka vendosur që aplikantët fitues nga këto komunitete gjatë fazës së rregjistrimit duhet të dorëzojnë vetdeklarimin mbi përkatësinë etnike ose një dokument që vërteton se janë pjesë e komunitetit rom/egjiptian. Gjithashtu, pavarësisht parashikimit në VKM-në përkatëse për pagesën vjetore të shkollimit, Fakulteti i Shkencave Sociale u ka dhënë mundësinë studentëve të Programeve Master, ta paguajnë me këste më të reduktuara.

Pra, siç shihet, nga ana e Fakultetit të Shkencave Sociale janë marrë të gjitha masat për të bërë të mundur rregjistrimin e studentëve të komunitetit rom/egjiptian.

Së dyti, referuar në VKM nr. 269, datë 29.03.2017 për *“Përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”*, asnjë student i Programit të dytë të studimeve, pra Master, nuk përjashtohet nga tarifa vjetore e shkollimit.

Pra, në total, nga të gjitha kategoritë që parashikon VKM-ja përkatëse, janë përjashtuar nga tarifa vjetore e shkollimit, të 40 studentëve të programit Bachelor dhe u është dhënë mundësia e pagesës me këste të tarifës së shkollimit 10 studentëve rom/egjiptian.

Neni 7, pika 1, e ligjit *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”*.

Në këto kushte, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioneri gjykon se studentët rom/egjiptian nuk i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e Fakultetit të Shkencave Sociale, sa i takon përjashtimit nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2017-2018.*

B. Shkaku i diskriminimit i pretenduar nga ankuesja.

“Raca” është njëri nga shkaqet, për të cilat Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Lidhur me pretendimin e subjektit ankues për diskriminim për shkak të racës, nga ana e Fakultetit të Shkencave Sociale, Komisioneri thekson faktin se pavarësisht se studentët i përkasin komunitetit rom/egjiptian, nuk janë vënë në pozita diskriminuese nga ana e Fakultetit të Shkencave Sociale për këtë shkak.

Lidhur me përjashtimin nga tarifa e shkollimit të studentëve të Programeve Master të Universitetit të Tiranës dhe mbështetur në përcaktimet e VKM-së nr. nr. 269, datë 29.03.2017 për *“Përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”*, Komisioneri konstaton se studentët i përkasin komunitetit rom/egjiptian nuk janë vënë në pozita diskriminuese nga ana e Universitetit të Tiranës për këtë shkak, pasi asnjë student i Programit Master, nuk përjashtohet nga tarifa vjetore e shkollimit.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, gërma “c”, nenit 33, pika 10, e Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të racës, të studentëve të komunitetit rom/egjiptian nga ana e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Universitetit të Tiranës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

KOMISIONERI

Irma BARAKU

(Shkaku: Raca)

(Fusha: Arsim)